



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:134490

Datë: 10.07.2024

Numri i dokumentit: 05922505

AA.nr.361/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrativ, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Ramiz Kuqi kryetar i kolegjit, Hajriz Hoti dhe Delushe Halimi anëtarë, në çështjen e konfliktit administrativ sipas padisë së paditësit, S.T- Shtërpce, kundër të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përfaqësuar nga Ardita Perçuku Shyti, për shkak të anulimit të vendimit, përkitazi me ankesën e paditësit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative A.nr.1668/2022, të datës 26.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 08.07.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

Miratohet si e bazuar ankesa e paditësit, S.T- Shtërpce, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1668/2022, i datës 26.04.2023, anulohet, dhe lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1668/2022, të datës 26.04.2023, është vendosur, “Hedhet poshtë si e palejuar padia e paditësit S.T, Shtërpce, nën shenjën A.nr.1668/2022 datë 30.06.2022, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit të të paditurit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në Prishtinë nr.3339/2022 datë 08.06.2022”

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankese paditësi, përmes të autorizuarit të tij, avokat Sami Rekaj, nga Ferizaji, me të cilën konteston ligjshmërinë e aktvendimit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet ankesa e paditësit si e bazuar, ndërsa aktvendimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet ose të priset dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të aktvendimit të kundërshtuar në pajtim me nenin 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka gjetur se, ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, me datë 30.06.2022, ka ushtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për anulim të vendimit të paditurës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me seli në Prishtinë me numër 3339/2022 të datës 08.06.2022.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditësit, e hedhë poshtë padinë e paditësit si të palejuar me arsyetim se, “ Gjykata ka vlerësuar se a janë plotësuar prezumimet procedurale për inicimin e konfliktit administrativ në raport me vendimin e të paditurit, sepse vendimi i të paditurit nuk është vendim përfundimtar në procedurë administrative, kjo për faktin se me dispozitën e nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative, është përcaktuar se “Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative”. Ndërsa me nenin 10 par.1 të te njëjtit ligj, është përcaktuar se “Të drejtë për të nisur konfliktin administrativ ka personi fizik si dhe personi juridik, nëse vlerëson se me aktin administrativ përfundimtar në procedurën administrative, i është shkelur ndonjë e drejtë apo interes ligjor”. Kurse me dispozitën e nenit 15 par.1 pika 1.2 të te njëjtit ligj, i cili rregullon rastet se kur nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ, përcaktohet se “1. Konflikti administrativ nuk mund të zhvillohet: 1.2. kundër akteve të nxjerra në çështjet rreth të cilave, sipas dispozitës së ligjit nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ”. Po ashtu, me dispozitën ligjore nga neni 34 par.1 pika 1.5 të te njëjtit ligj është përcaktuar se “1. Gjykata e hedh poshtë padinë me vendim, nëse konstaton se: 1.5. është fjala për çështjen për të cilën sipas dispozitës shprehimore të ligjit nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ”. Prandaj, duke u bazuar në këto dispozita ligjore të lartcekura, Gjykata e shkallës së parë e ka hedhë poshtë padinë e paditësit në këtë çështje juridiko-administrative si të palejuar, kjo për faktin se vendimi i të paditurit i kontestuar me padi nga paditësi, me të cilin është shfuqizuar njoftimi i datës 28.03.2022 për rezultatet e përzgjedhjes përfundimtare të kandidatit për procedurës e rekrutimit “Përfaqësues ligjor komunal”, i shpallur nga Komuna e Shtërpçës si dhe është anuluar procedura e rekrutimit për pozitën “Përfaqësues ligjor komunal”, e shpallur nga Komuna e Shtërpçës më datë 18.01.2022 dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga kjo nga kjo procedurë. Shfuqizohet akt emërimi me nr.prot 02-030101-4155/22 i datës 01.04.2022 i kandidatit të përzgjedhur S.T, po ashtu është obliguar Kryetari i Komunës së Shtërpçës që të bëj zbatimin e vendimit brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, si dhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim dhe në raport me këtë lloj të vendimit nuk mund të hapet konflikt administrativ me padi, por organi i shkallës së parë, në këtë rast Komuna e Shtërpçës është e detyruar që prapë të vendos çështjen sipas udhëzimeve të dhëna nga i padituri në arsyetimin e vendimit të kontestuar, përkatësisht është e obliguar që të veprojë në afatin e përcaktuar sipas vërejtjeve të organit të shkallës së dytë, duke nxjerrë vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, bazuar në shkresat e lëndës dhe pas ekzaminimit të aktvendimit, e duke i pasur parasysh edhe pretendimet ankimore, gjen se aktvendimi i kontestuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 nën paragrafi n), i aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konflikte Administrative, pasi që i njëjti është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten

dhe me arsyetimin e tij, dhe si i tillë është jo i plotë edhe në vërtetimin e gjendjes faktike dhe në zbatim të gabuar të procedurës, përkatësisht të nenit 9, nenit 10 dhe nenit 13 të LKA-së, për çka në mënyrë të bazuar pretendohet në ankesë.

Kolegji i apelit vlerëson se Gjykata e shkallës së parë nuk ka vendosur drejtë kur e ka hedhur poshtë si të pa lejuar padinë e paditësit, kjo për faktin se me dispozitën e nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative, është përcaktuar se *“Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative”*. Ndërsa me nenin 10 par.1 të te njëjtit ligj, është përcaktuar se *“Të drejtë për të nisur konfliktin administrativ ka personi fizik si dhe personi juridik, nëse vlerëson se me aktin administrativ përfundimtar në procedurën administrative, i është shkelur ndonjë e drejtë apo interes ligjor”*. Kurse me dispozitën e nenit 15 par.1 pika 1.2 të te njëjtit ligj, i cili rregullon rastet se kur nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ, përcaktohet se *“1. Konflikti administrativ nuk mund të zhvillohet: 1.2. kundër akteve të nxjerra në çështjet rreth të cilave, sipas dispozitës së ligjit nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ”*. Po ashtu, me dispozitën ligjore nga neni 34 par.1 pika 1.5 të te njëjtit ligj është përcaktuar se *“1. Gjykata e hedh poshtë padinë me vendim, nëse konstaton se: 1.5. është fjala për çështjen për të cilën sipas dispozitës shprehimore të ligjit nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ”*.

Prandaj, duke u bazuar në këto dispozita ligjore të lartcekura, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, siç u theksua më lartë nuk ka vendosur drejtë kur ka hedhë poshtë si të palejuar padinë e paditësit në këtë çështje juridiko-administrative, ngase vendimi i të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër 3339/2022 i datës 08.06.2022, i kontestuar me padi nga paditësi, është vendim përfundimtar në procedurën administrative, dhe në raport me këtë lloj të vendimit mund të hapet konflikt administrativ me padi, për faktin se me të njëjtin vendim e paditura nën pikën I, të dispozitivit ka aprovuar si të bazuar ankesën me numër A.nr.363/2022 të datës 13.04.2022 të ushtruar nga ankuesi J.A. Në pikën II të dispozitivit shfuqizohet njoftimi i datës 28.03.2022 për rezultatet e përzgjedhjes përfundimtare të kandidatit për procedurës e rekrutimit “Përfaqësues ligjor komunal”, i shpallur nga Komuna e Shtërpçës. Në pikën III e ka anuluar procedurën e rekrutimit për pozitën “Përfaqësues ligjor komunal”, e shpallur nga Komuna e Shtërpçës më datë 18.01.2022 dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga kjo nga kjo procedurë. Në pikën IV shfuqizohet akt emërimi me nr.prot 02-030101-4155/22 i datës 01.04.2022 i kandidatit të përzgjedhur S.T, Në pikën V Obligohet Kryetari i Komunës së Shtërpçës që të bëjë zbatimin e vendimit brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi. Në pikën VI Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Sipas vlerësimit të kolegjit të apelit ky lloj vendimi është akt përfundimtar në procedurë administrative, kjo për faktin se me të njëjtin vendim është aprovuar ankesa e ankuesit dhe është anuluar procedura e rekrutimit për pozitën përfaqësues ligjor komunal dhe ka mbetur jashtë fuqie akt emërimi i kandidatit të përzgjedhur S.T, dhe se nuk e ka aprovuar në tërësi ankesën e ankuesit. Kjo për faktin se vetëm në rastet kur e paditura aprovon në tërësi ankesën e ankuesit, dhe çështjen e kthen në organin e shkallës së parë në rivlerësim apo rivendosje, atëherë konsiderohet se i njëjti

vendim nuk është akt përfundimtar në procedurë administrative, por jo edhe në rastin e paditësit kur është shfuqizuar akt emërimi i kandidatit të përzgjedhur.

Sipas vlerësimit të kolegjit të apelit, ky lloj i vendimit nuk hynë në kategorinë e vendimeve të cilat Gjykata Kushtetuese i ka konsideruar së nuk janë vendime përfundimtare, me vendimin e saj nr.ref.RK1355/2019 të 02 majit 2019, në rastin KI190/18, me parashtruese, F.J, ku në pikën 31 të tij thekson se “Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Themelore A.nr.1531/16, të 5 shtatorit 2018 dhe Vendimin e KPMSHCK-së, A.nr.719/2018, të 4 dhjetorit 2018”. Pika 32 e vendimit thekson se “Gjykata së pari vëren se vendimet e kontestuara nuk janë përfundimtare dhe se me vendimet e kontestuara nuk është vendosur për meritat e kontestit, por se me të njëjtat objekti i kontestit është kthyer në rivendosje në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Gjykatën Themelore në Gjilan”.

Për arsyet e lartcekura, aktvendimi i kundërshtuar është dashtë të priset dhe çështja t’i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje, për t’i mënjanuar shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës të theksuara më lartë, që janë të tilla që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit të goditur.

Në ri-procedurë Gjykata e shkallës së parë detyrohet të caktoj seancën e shqyrtimit përgatitor apo kryesor, dhe varësisht nga propozimet e palëve, dhe vlerësimit të provave që gjinden në shkresat e lëndës të vendosë për çështjen kontestuese në mënyrë të plotë dhe të drejtë.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 dhe 63 të Ligjit për Konflikte Administrative, lidhur me nenin 208, dhe 209 paragrafi 1 nën paragrafi d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - PRISHTINË
AA.nr.361/2023, datë;08.07.2024

Kryetari i kolegjit,
Ramiz Kuqi